



FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT
NDERMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE, BASHKIA KORÇE

Date 19.12.2018

Për: *Shqerine, "VILDEV - CO" me NIPT J76705047U dhe shoqerine A.L-ASFALT me NIPT K81511508A adresat perkatesisht : Korce Korçe KORCE Lagjja 17, Rruga Riza Mançe, Nr.21 dhe Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Komuna Xhafzotaj, Prane Kryqezimit 4 Rruget.*

Procedura e prokurimit: **"Riparim sistem vaditje ne forme shiu njesia administrative Voskop"**

Numri i referencës së procedurës/loti : **REF-95406-11-22-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *Kjo kontrate ka per qellim realizimin e punimeve me objekt riparim sistem vaditje ne forme shiu njesia administrative Voskop".*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet):

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: *çmimi më i ulët*

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1. Shoqeria "NIKA" SH.P.K, NIPT J76705047U me vleren:

2,346,190 (dy milion e treqind e dyzet e gjashte mije e njeqind e nentedhjete) leke

2. Bashkimi i Operatoreve Ekonomike, Shoqeria "VILDEV-CO" SH.P.K, NIPT K83926001F dhe shoqeria "A.L-ASFALT" SH.P.K, NIPT K81511508A me vleren:

2,407,240 (dy milion e katerqind e shtate mije e dyqind e dyzet) leke

3. Shoqeria "SARK" SH.P.K, NIPT K52531415H me vleren:

2,863,705.90 (dy milion e teteqind e gjashtedhjete e tre mije e shtateqind e pese pike nentedhjete) leke

4. Shoqeria "SHAMO CONSTRUCTION" SH.P.K, NIPT L01326020F me vleren:

3,013,450 (tre milion e trembedhjete mije e katerqind e pesedhjete) leke

5. Shoqeria "ALB KORÇA 2002" SH.P.K, NIPT K34004003T me vleren:

3,069,440 (tre milion e gjashtedhjete e nente mije e katerqind e dyzet) leke

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Shoqeria “NIKA” SH.P.K, per arsye se:

1.Operatori ekonomik nuk ka plotësuar kërkesat e dokumenteve standarte të tenderit , kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 4, në të cilën shprehimisht kërkohet: “Një punësim mesatar i prej të paktën **22 (njetzet e dy) personash**, per periudhen **Shtator 2017- Shtator 2018** e dokumentuar kjo me vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga administrata tatimore, prej te cileve **shofere 2 (dy) persona**”

Per shoferet duhet te paraqitet:

- Çertifikatën e aftësisë profesionale të lëshuar nga zyra kompetente e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor
- Leje drejtimin e lëshuar nga dega e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor
- kontrata e punes

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për shoferin Fran Kasneci nuk është paraqitur Leja e Drejtimit dhe Certifikata e Aftësisë Profesionale në kundërshtim me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit.

2. Kontrata e punës së inxhinierit të mjedisit Eltorr Goxhaj, e lidhur me shoqërinë në datën 26.09.2017 me afat 1 vjeçar është jashtë afatit të vlefshmërisë në kundërshtim kjo me kriteret e veçanta të kualifikimit pika **4 ku mes të tjerash kërkohet: “... për efekt të kryerjes së punimeve në tërësi, kërkohet që të kete stafin inxhinierik si më poshtë:**

- Inxhinier mjedisi **(1) nje**

Per inxhinierin e mjedisit duhet te paraqitet

- Diplome
- kontrata e punes

2. Shoqeria “SARK” SH.P.K, per arsye se:

1.Operatori ekonomik nuk ka plotësuar kërkesat e dokumenteve standarte të tenderit , kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 4, në të cilën shprehimisht kërkohet: “Një punësim mesatar i prej të paktën **22 (njetzet e dy) personash**, per periudhen **Shtator 2017- Shtator 2018** e dokumentuar kjo me vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga administrata tatimore, prej te cileve **shofere 2 (dy) persona**”

Per shoferet duhet te paraqitet:

- Çertifikatën e aftësisë profesionale të lëshuar nga zyra kompetente e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor
- Leje drejtimin e lëshuar nga dega e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor
- kontrata e punes

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për shoferin B.Zenunaj nuk është paraqitur Certifikata e Aftësisë Profesionale në kundërshtim me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit.

3. Shoqeria “SHAMO CONSTRUCTION” SH.P.K, per arsye se:

1.Operatori ekonomik nuk ka shlyer detyrimet e maturuara të energjisë elektrike për muajin tetor 2018 në kundërshtim kjo me kriteret e veçanta të kualifikimit ku kërkohet:

Vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Vërtetimi nr. 9011 datë 29.10.2018 nuk vërteton shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për muajin tetor 2018.

4. Shoqeria “ALB KORÇA 2002” SH.P.K, per arsye se:

1.Nuk është paraqitur dokumenti i kërkuar Diplomë për inxhinierin Hidroteknik Z. A. Hysaj në kundërshtim kjo me kriteret e veçanta të kualifikimit pika **4 ku mes të tjerash kërkohet:** “... për efekt të kryerjes së punimeve në tërësi, kërkohet që të kete stafin inxhinierik si më poshtë:

- Inxhinier hidroteknik **(1) nje**

Per inxhinierin hidroteknik duhet te paraqitet:

- Diplome
- kontrata e punes.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqerite “**VILDEV-CO**” SH.P.K dhe “**A.L-ASFALT**” SH.P.K, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **2,407,240 (dy milion e katerqind e shtate mije e dyqind e dyzet) leke pa tvsh** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Ndermarrjes se Sherbimeve Publike,Bashkise Korçë** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të së këtij njoftimi, por jo me vone se 5 dite nga kerkesa per lidhjen e kontrates.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

*Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : **11.12.2018***

Ankesa: **Nuk ka**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ILIRJAN DINELLARI**